



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
UNIVERSITY OF PRIZREN



“Ukshin Hoti”

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01 - 1346

Prizren, me 03. 10. 2014

U.d.Rektori
Prof. Dr. Zahadin Shemsidini

Mbështetur në dispozitat e nenit 100 të Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, nr.04 – V – 621, të datës 30 maj 2013,

UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”
shpall

KONKURSIN

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve Master Shkencorë, **“TRASHËGIMI KULTURORE DHE MENAXHIM NË TURIZËM”** në vitin akademik 2014 - 2015

Në këtë nivel të studimeve do të regjistrohen **25 studentë**.

KUSHTET E KONKURSIT

Kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë në këtë program studimesh, duhet të kenë të përfunduar studimet e nivelit themelor në njërin nga këto drejtime:

- **Turizëm dhe Trashëgimi Kulturorë;**
- **Arkitekturë;**
- **Antropologji;**
- **Histori;**
- **Arkeologji;**
- **Gjeografi;**
- **Administrim Publik dhe**
- **Administrim Biznesi.**

Kandidatët e interesuar duhet të kenë **notën mesatare së paku 8.00 dhe 180 (ECTS), nga studimet themelore të përfunduara në Universitetet Publike).**

Njohja e mirë e gjuhës angleze është përparësi.

Përzgjedhja e kandidatëve të suksesshëm deri në numrin e përcaktuar sipas këtij konkursi, bëhet sipas ranglistës prioritare të ranguar nga maksimumi i vlerësimit të komisionit intervistues dhe të notës mesatare të arritur gjatë studimeve themelore.

Testimi i njohurive të kandidatëve organizohet në lokalet e Universitetit të Prizrenit dhe mbahet më datë **22.10.2014** duke filluar nga ora **10.00**

Kandidatët e pasuksesshëm mund të ankohen kundër vendimit të komisionit, brenda dy ditëve të punës nga dita e shpalljes së rezultateve.

Vendimi përfundimtar rreth ankesave të parashtruara, merret nga **Komisioni për ankesa** i emëruar nga Rektori i Universitetit të Prizrenit.

AFATET PËR PARAQITJE

Afati për paraqitje të dokumenteve është prej datës **07.10.2014 deri më 17.10.2014 në ora 15,30.**

Kandidatët e interesuar duhet t'i sjellin këto dokumente të vërtetuara nga noteria publike:

1. Formulari i aplikimit dhe fletëpagesa plotësohet në adresën uni- prizren.com;
2. Certifikatën e lindjes me numër personal;
3. Diplomën ose certifikatën e kryerjes së fakultetit;
4. Certifikatën e notave (për të gjitha provimet) me notë mesatare.

Kandidatët të cilët studimet themelore i kanë përfunduar jashtë vendit, diplomën duhet ta kenë të nostrifikuar nga MASHT.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në **UPZ** në **Zyrën nr. 306**

Kandidatët me rastin e paraqitjes paguajnë **10** euro.

Shpallja e rezultateve të testimit të njohurive të kandidatëve bëhet më **datë 27.10.2014**

Regjistrimi i studentëve të pranuar bëhet në Administratën e Universitetit të Prizrenit, me datë **28.10.2014 dhe 31.10.2014** nga ora **9.00**

Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin:

- Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili merret në Administratën e Universitetit të Prizrenit);
- Dy fotografi të formatit **6x4 cm.**;
- Fletëpagesën në **4 kopje**, në shumën prej **150.00** për një semestër, e cila merret në UPZ, Zyrja nr. 21.

Pagesa bëhet në njërin prej bankave komerciale të Kosovës .

Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët mund t'i drejtohen UPZ-së ose ta hapin faqen e internetit www.uni-prizren.com.